

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.4-A

Data: 8 prill 2009

Originali: anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësit Liu Daqun, Kryegjykatës
Gjykatësit Mohamed Shahabuddeen
Gjykatësit Mehmet Güney
Gjykatësit Fausto Pocar
Gjykatëses Andrésia Vaz

Ushtruesi i: Z. John Hocking
Detyrës së Sekretarit

Vendim i datës: 8 prill 2009

PROKURORI

kundër

**ASTRIT HARAQISË
dhe
BAJRUSH MORINËS**

PUBLIK

**VENDIM NË LIDHJE ME MOCIONIN E ASTRIT HARAQISË
PËR LIRIM TË PËRKOHSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Zj. Barbara Goy

Avokatit të Astrit Haraqisë:

Z. Karim A.A. Khan

Avokatit të Bajrush Morinës:

Z. Jens Dieckmann

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali Ndërkombëtar”) është informuar për “Mocionin e Astrit Haraqisë për Lirimin në Mbarimin e Dënimit ose Ndryshe, Lirim deri në Vendimin e Apelit” dorëzuar më 1 prill 2009 (“Mocion”) prej Astrit Haraqisë (“Haraqija”). Prokuroria ka bërë të ditur se nuk do të paraqesë përgjigje.

I. RRETHANAT

2. Më 25 prill 2008, Dhoma Gjyqësore I lëshoi një urdhëresë për arrestimin e Haraqisë bazuar mbi akuzat për shpërfillje të Tribunalit Ndërkombëtar.¹ Më 28 prill 2008 Haraqija u dorëzua dhe u transferua në Hagë për procesin gjyqësor.² Dhoma Gjyqësore miratoi lirim të përkohshëm për të gjatë fazave paragjyqësore dhe gjyqësore.³ Më 17 dhjetor 2008, ajo e shpalli fajtor për shpërfillje të Tribunalit Ndërkombëtar bazuar në Rregullën 77(A)(iv) të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) dhe e dënoi me pesë muaj burgim duke llogaritur 36 ditë burgimi të kryera.⁴ Haraqija dorëzoi Njoftimin për Apel kundër verdiktit të fajësisë së tij më 2 janar 2009.⁵ Në të njëjtën ditë, Prokuroria dorëzoi Njoftimin e vet për Apel ku kundërshtone dënimin e dhënë nga Dhoma Gjyqësore dhe kërkonte zgjatjen e burgimit në dy vjet.⁶

3. Nëqoftëse Haraqija nuk do të kishte dorëzuar njoftimin për apel, dënimi i tij caktuar prej Dhomës Gjyqësore do të kishte përfunduar që prej 10 prillit 2009. Më 1 prill 2009 Haraqija dorëzoi këtë mocion ku kërkohet lirimi në mbarimin e dënimit të tij ose ndryshe lirim i përkohshëm deri në vendimin mbi apelin.⁷ Në rrethana të ngjashme, më 9 shkurt 2009, Dhoma e Apelit miratoi lirim të përkohshëm për Bajrush Morinën, i bashkakuzuar me Haraqinë, deri në përfundim të procedurës së apelit.⁸ Gjithashtu Dhoma e Apelit thekson se

¹ Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4. Aktgjykim në lidhje me Akuzat për Shpërfillje, 17 dhjetor 2008, paragrafët 61, 120 (“Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore”), paragrafët 5, 11

² Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 11; Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4. Vendim në Lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm të të Akuzuarit Astrit Haraqija, 15 shtator 2008 (“Vendimi i Dytë në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Haraqisë”), paragrafi 8; Mocion, paragrafi 4, 16.

³ Haraqisë iu miratua lirim i përkohshëm më 13 maj 2008 dhe 15 shtator 2008, shih Prokurori kundër Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës, Lënda Nr. IT-04-84-R77.4, Vendim në Lidhje me Kërkesën për Lirimin e Përkohshëm të Astrit Haraqisë, 13 maj 2008, paragraf 17; Vendimi i Dytë në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Haraqisë, paragrafi 13.

⁴ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 102, 120, 121.

⁵ Njoftimi i Astrit Haraqisë për Apelin e “Aktgjykimit mbi Akuzat për Shpërfillje” i datës 17 dhjetor 2008, 2 janar 2009. Edhe i bashkakuzuari i Haraqisë, Bajrush Morina, e dorëzoi Njoftimin e tij për Apel kundër verdiktit të fajësisë dhe dënimit të tij më 2 janar 2009. Shih Njoftim për Apel në Emër të Bajrush Morinës, 2 janar 2009.

⁶ Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 2 janar 2009, f.1.

⁷ Mocion, paragrafët 2, 12, 13.

⁸ Vendim në lidhje me Mocionin e Bajrush Morinës për Lirim të Përkohshëm, 9 shkurt 2009 (“Vendimi për Lirimin e Përkohshëm të Morinës”), paragrafët 10-12.

Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës ka bërë të ditur se nuk ka kundërshtim ndaj lirimit të përkohshëm të Haraqisë

II. DISKUTIM

4. Sipas Rregullës 102(A) të Rregullores “sapo të jetë dhënë njoftimi për apel, pezullohet zbatimi i aktgjykimit deri në shpalljen e vendimit të apelit, ndërkohë që personi i shpallur fajtor mbetet në paraburgim”.⁹ Haraqija dhe Prokuroria i paraqitën njoftimet për apel më 2 janar 2009, duke kundërshtuar përkatësisht verdiktin e e fajësisë dhe dënimin. Si rezultat pjesa e mbetur e dënimit të dhënë prej Dhomës Gjyqësore kundër Haraqisë nuk do të ketë përfunduar më 10 prill 2009 meqenëse është pezulluar deri në vendimin e apelit. Rrjedhimisht, në kundërshtim me argumentet e Haraqisë, në këto rrethana, fakti se dënimi i tij i dhënë prej Dhomës Gjyqësore do të kishte përfunduar më 10 prill 2009, nuk përbën në vetvete arsye për lirimin e tij.

5. Mirëpo personi i shpallur fajtor mund të lirohet përkohësisht deri në vendimin e apelit bazuar në Rregullën 65(I) të Rregullores, nëqoftëse Dhoma e Apelit bindet se: “(i) nëqoftëse lirohet, apeluesi do të paraqitet në seancën e apelit, ose do të dorëzohet në paraburgim në përfundim të periudhës së përcaktuar, sipas rastit; (ii) nëqoftëse lirohet, apeluesi nuk do të përbëjë rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjetër; dhe (iii) ekzistojnë rrethana të veçanta që përligjin lirimin.”¹⁰ Këto kushte duhen shqyrtuar në tërësi.¹¹ Plotësimi i këtyre kushteve prej kërkuesit përcaktohet duke u bazuar në balancën e gjasave, dhe gjatë peshimit të gjasave Dhoma e Apelit duhet të marrë gjithashtu parasysh faktin se individi tashmë është dënuar.¹² Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentet e Haraqisë në lidhje me secilin prej kritereve të mëposhtme.

⁹ *Shih edhe* Vendimin për Lirimin e Përkohshëm të Morinës, para 3.

¹⁰ *Shih edhe* Vendimin për Lirimin e Përkohshëm të Morinës, para 3.

¹¹ Vendimi për Lirimin e Përkohshëm të Morinës, para 3. *Shih gjithashtu Prokurori k. Pavle Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-A, Vendim në lidhje me Kërkesën e Përsëritur të Mbrojtjes ku Kërkohet Lirim i Përkohshëm për Arsye Humanitare, 15 prill 2008, paragrafi 5; *Prokurori k. Pavle Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-A, Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes ku Kërkohet Lirim i Përkohshëm për Arsye Humanitare, 2 prill 2008, paragrafi 3; *Prokurori kundër Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Vendim në lidhje me Mocionin në Emër të Enver Haxhihasanoviqit për Lirim të Përkohshëm, 20 qershor 2007, para 8; *Prokurori kundër Radosllav Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-A, Vendim në lidhje me Mocionin e Radosllav Bërgjaninit për Lirim të Përkohshëm, 23 shkurt 2007, paragraf 5.

¹² *Po aty*

A. Nëqoftëse lirohet, apeluesi do të paraqitet në seancën e apelit, ose do të dorëzohet në paraburgim në përfundim të periudhës së përcaktuar, sipas rastit.

6. Haraqija parashtron se nëqoftëse lirohet përkohësisht deri në vendimin e apelit ai “do t’i dorëzohet juridksionit të [Tribunalit Ndërkombëtar] kurdoherë që do të urdhërojë Dhoma e Apelit”.¹³ Në lidhje me këtë pikë, ai thekson se “nuk ka dhënë as shkakun më të vogël për dyshimin se nuk do t’i dorëzohej Tribunalit vullnetarisht”, duke qenë se ka bashkëpunuar plotësisht gjatë procesit dhe ka respektuar kushtet e vendosura prej Dhomës Gjyqësore gjatë lirimit të tij të mëparshëm.¹⁴

7. Haraqija u shpall fajtor për shpërfillje, e cila është shkelje veçanërisht e rëndë. Mirëpo Dhoma e Apelit gjithashtu vë në dukje se Dhoma Gjyqësore e dënoi Haraqinë me pesë muaj burgim, që do të kishte përfunduar më 10 prill 2009, nëqoftëse palët nuk do të kishin dorëzuar njoftimet për apel. Megjithëse gjatë pritjes së vendimit në lidhje me apelin e Prokurorisë që kërkon një zgjatje të dënimit, Haraqija mund të ketë motiv për t’u arratisur, Dhoma e Apelit gjykon se dy fakte anojnë kundër këtij opsiioni. Së pari, Haraqija iu dorëzua vullnetarisht Tribunalit sapo u vu në dijeni për Aktakuzën kundër tij.¹⁵ Së dyti, ai ka një praktikë të rikthimit në paraburgim pas lirimit të përkohshëm dhe të përmbushjes së kushteve të tjera të përcaktuara prej Dhomës Gjyqësore për lirin përkatës.¹⁶ Këta faktorë sugjerojnë se nëqoftëse lirohet përkohësisht, ai do të dorëzohej në paraburgim kur t’i kërkohej prej Dhomës së Apelit.

8. Dhoma e Apelit vë në dukje se Haraqija nuk ka paraqitur garanci shtetërore në mbështetje të Mocionit të tij dhe i kërkon Dhomës së Apelit të udhëzojë Sekretarinë për të verifikuar gatishmërinë dhe aftësinë e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) për garantimin e përmbushjes së çfarëdo kushti të vendosur për lirin.¹⁷ Megjithëse paraqitja e garancisë shtetërore nuk është parakusht për lirim të përkohshëm, përgjithësisht është e këshillueshme që paraqitësi i kërkesës për lirim të përkohshëm të dorëzojë garanci për t’a bindur Tribunalin Ndërkombëtar se ai do të paraqitet

¹³ Mocion, para 18.

¹⁴ Mocion, paragrafët 14-18.

¹⁵ Vendimi i Dytë në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Haraqisë, para 8.

¹⁶ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, para 11.

¹⁷ Mocion, para 25 (ii).

kur t'i kërkohet.¹⁸ Për rastin në fjalë, Dhoma e Apelit është në dijeni se UNMIK-u në këshillim me Sekretarinë, ka bërë të ditur se do të ishte i gatshëm të ofronte garanci për Haraqinë, të ngjashme me atë që u vendos për të bashkakuzuarin e tij Morinën dhe do të plotësonte çfarëdo udhëzimi të Dhomës së Apelit në rast të lirimit të përkohshëm. Dhoma e Apelit e pranon këtë si garanci të mjaftueshme të plotësimit të kushteve.

9. Bazuar në sa më sipër, Dhoma e Apelit është e bindur se Haraqija nuk përbën rrezik arratisjeje dhe rrjedhimisht plotëson kushtet e Rregullës 65 (I)(i) të Rregullores.

B. Nëqoftëse lirohet, apeluesi nuk do të përbëjë rrezik për viktima, dëshmitarë apo persona të tjerë

10. Haraqija argumenton se sjellja e tij e mirë gjatë procesit tregon se ai nuk do të përbëjë rrezik për viktima, dëshmitarë apo persona të tjerë të mbrojtur dhe vë në dukje se periudhat e mëparshme të lirimit të tij të përkohshëm ishin pa incidente.¹⁹ Dhoma e Apelit është e bindur se me të vërtetë periudhat e kaluara të lirimit të përkohshëm të Haraqisë ishin pa incidente dhe se sjellja e tij gjatë procesit të tij tregon se ai nuk paraqet rrezik ndaj viktimave, dëshmitarëve apo personave të tjerë siç përcaktohet prej Rregullës 65(I)(ii) të Rregullores.

C. Ekzistojnë rrethana të veçanta që përligjin lirimin

11. Së fundi, Haraqija parashtrohet se ekzistojnë rrethana të veçanta që përligjin lirimin e tij të përkohshëm sepse më 10 prill 2009, ai do të ketë kryer dënimin pesëmuajor të përcaktuar prej Dhomës Gjyqësore.²⁰ Gjithashtu ai thekson se duke qenë se nuk është caktuar data për shpalljen e Aktgjykimit të Dhomës së Apelit në këtë çështje, nuk ekzistojnë arsye kundër miratimit të lirimit të tij të përkohshëm deri në vendimin e apelit.²¹

12. Dhoma e Apelit tashmë ka përcaktuar në këtë çështje në lidhje me Bajrush Morinën, të bashkakuzuarin e Haraqisë, se fakti që apeluesi do të kishte kryer krejt dënimin e dhënë prej Dhomës Gjyqësore nëqoftëse nuk do të ishin dorëzuar njoftimi për apel, mund të përbëjë

¹⁸ Vendimi për Lirimin e Përkohshëm të Morinës, para 6; *Prokurori kundër Vidoje Bilagojeviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-02-53-AR65, Vendim në lidhje me Kërkesën e Dragan Jokiçit për Leje për Apelim, 18 prill 2002, paragrafët 7-8; *Shih edhe Prokurori kundër Jadranko Përlitit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-PT, Urdhëresë në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Berislav Pushiqit, 30 korrik 2004, paragraf 32.

¹⁹ Mocion, paras 19-21.

²⁰ Mocion, para 22.

²¹ Mocion, para 23.

rrethanë të veçantë.²² Meqenëse Haraqija ka të njëjtin mendim, edhe Dhoma e Apelit gjykon se ekzistojnë rrethana të veçanta që përligjin lirimin e tij të përkohshëm.

III. KUSHTET E LIRIMIT TË PËRKOHSHËM

13. Dhoma e Apelit konkludon se Haraqija ka përmbushur të tëra kushtet e nevojshme për miratimin e lirimit të përkohshëm sipas Rregullës 65(I). Haraqija kërkon që në rast se ai do të lirohet përkohësisht, të mos vendoset asnjë kusht për lirimin e tij duke qenë se ai do të ketë kryer krejt dënimin e tij.²³ Ndryshe, Haraqija parashtrohet se nëqoftëse Dhoma e Apelit gjykon se lirimi i tij duhet të ketë kushte, ai kërkon që t'i lejohet lëvizje e lirë dhe e pakufizuar brenda Kosovës.²⁴

14. Dhoma e Apelit thekson se ndonëse në kohën e lirimit Haraqija do ta kishte kryer krejt dënimin e dhënë prej Dhomës Gjyqësore, ai ende ka statusin e personit të shpallur fajtor në bazë të Rregullës 102 të Rregullores. Rrjedhimisht ai nuk është në të njëjtën pozitë si një person që ka kryer dënimin pas përfundimit të procesit penal kundër tij. Gjithashtu dënimi i tij është apeluar dhe kjo mund të rezultojë në një dënim më të gjatë. Duke marrë parasysh këto rrethana, Dhoma e Apelit konkludon se ekziston nevoja për kushte që kufizojnë lëvizjen e tij për të garantuar se Haraqija do të jetë i disponueshëm për t'u dorëzuar në paraburgim kur t'i kërkohej prej Dhomës së Apelit. Si pasojë Dhoma e Apelit hedh poshtë kërkesat e Haraqisë në lidhje me kushtet e lirimit të tij të përkohshëm. Faktikisht Dhoma e Apelit, e gjykon të përshtatshme të vendosë për Haraqinë të njëjta kushte të lirimit të përkohshëm në fuqi gjatë procesit gjyqësor.²⁵

IV. VENDIM

15. Për arsyet e lartpërmendura dhe bazuar në Rregullat 102(A) dhe 65(I) të Rregullores, Dhoma e Apelit **MIRATON** Mocionin pjesërisht, dhe

²² Vendimi për Lirimin e Përkohshëm të Morinës, para 10; *Siç edhe Prokurori kundër Mile Mërkshiqit dhe Veselin Shlivançaninit*, Lënda Nr. IT-95-13/1-A, Vendim në lidhje me Mocionin e Veselin Shlivançaninit për Lirim të Përkohshëm, 11 dhjetor 2007, f.3. (ku theksohet që fakti se Shlivançanini kishte kryer 90 për qind të dënimit të dhënë nga Dhoma Gjyqësore përbënte rrethanë të veçantë); *Prokurori kundër Miroslav Kvoçkës*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Vendim në lidhje me Kërkesën e Kvoçkës për Lirim të Përkohshëm, 17 dhjetor 2003 ("Vendimi Kvoçka"), ff. 3, 4 (ku theksohet që fakti se Kvoçka kishte kryer 80 për qind të dënimit të dhënë nga Dhoma Gjyqësore përbënte rrethanë të veçantë).

²³ Mocion, para 24, 25(iii).

²⁴ Mocion, para 24, 25(iii).

URDHËRON që Haraqija të lirohet përkohësisht deri në vendimin e apelit me kushtet dhe kufizimet vijuese:

- a. Astrit Haraqija të transportohet prej autoriteteve holandeze për në aeroportin Schiphol në Holandë, praktikisht sa më shpejt;
- b. Në aeroportin Schiphol, Haraqija të lirohet me kusht nën mbikëqyrjen e oficerit të sigurimit caktuar prej Sekretarit të Tribunalit i cili e shoqëron Haraqinë për pjesën tjetër të udhëtimit të tij për në Kosovë;
- c. Në aeroportin e Prishtinës, Haraqija të pritët prej një zyrtari të caktuar prej UNMIK-ut, i cili ta shoqërojë Haraqinë për në vendbanimin e tij;
- d. Haraqija t'u japë autoriteteve të UNMIK-ut dhe Sekretarit të Tribunalit adresën ku do të qëndrojë në Kosovë para se të largohet prej Njesisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara ("NJPKB") në Hagë;
- e. Autoritetet e UNMIK-ut ta udhëzojnë Haraqinë se gjatë periudhës së lirimit të tij të përkohshëm me kusht, ai do t'u përmbahet këtyre kushteve
 - i. të qëndrojë brenda kufijve të komunës ku banon, por mund të lejohet që në këshillim me UNMIK-un të largohet një ditë në javë nga vendbanimi i tij midis orëve 10:00 dhe 18:00, për të parë prindërit e tij në Gjakovë, Kosovë;
 - ii. të mos ketë asnjë kontakt ose të mos ndërhyjë në asnjë mënyrë ndaj cilitdo viktime apo dëshmitari të mundshëm ose ndryshe të mos ndërhyjë në procedimin ose ushtrimin e drejtësisë;
 - iii. të mos diskutojë me askënd çështjen e tij, as me median, përveç avokatit të tij;
 - iv. të vazhdojë bashkëpunimin me Tribunalin;
 - v. t'u përmbahet përpikmërisht kushteve të autoriteteve të UNMIK-ut që janë të nevojshme për t'u mundësuar atyre përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Vendimi dhe garancitë e tyre;

²⁵ Vendimi i Dytë në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Haraqisë, ff. 6-8; *Prokurori k. Astrit Haraqisë dhe Bajrush Morinës*, Lënda Nr. IT-

- vi. t'i përmbahet përpikmërisht çfarëdo Urdhërese tjetër të Dhomës së Apelit që ndryshon kushtet e lirimit të tij të përkohshëm ose e përfundon atë.
- f. Autoritetet e UNMIK-ut të garantojnë që:
- i. pas mbërritjes në Kosovë, Haraqija t'ia dorëzojë pasaportën e tij autoriteteve të UNMIK-ut.
 - ii. Haraqija t'i raportojë çdo javë policisë së UNMIK-ut në vendbanimin e tij;
 - iii. Dhomës së Apelit t'i dërgohet një raport javor në lidhje me lirimin e përkohshëm me kusht të Haraqisë.
- g. Haraqija të kthehet në NJPKB në Hagë në një kohë që do të përcaktohet prej Dhomës së Apelit. Ai të shoqërohet nga vendbanimi i tij në Kosovë prej të njëjtit zyrtar të caktuar prej UNMIK-ut, i cili në aeroportin e Prishtinës, t'ia dorëzojë Haraqinë oficerit të sigurimit të caktuar prej Sekretarit të Tribunalit. Pas mbërritjes në aeroportin Schiphol, Haraqija t'u dorëzohet autoriteteve holandeze, dhe autoritetet holandeze ta transportojnë Haraqinë në NJPKB në Hagë.

KËRKON prej UNMIK-ut të marrë përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

- a. të caktojë një zyrtar të UNMIK-ut i cili ta shoqërojë Haraqinë nga aeroporti i Prishtinës në vendbanimin e tij dhe t'i informojë sa më shpejt Dhomën e Apelit dhe Sekretarin e Tribunalit për emrin e zyrtarit të caktuar;
- b. për të tëra shpenzimet në lidhje me transportin e Haraqisë prej aeroportit të Prishtinës për në vendbanimin e tij;
- c. me kërkesë të Dhomës së Apelit ose të palëve të ndihmojë në lidhje me tëra mjetet dhe format e bashkëpunimit dhe të komunikimit midis palëve dhe të garantojë konfidencialitetin e komunikimit;
- d. t'i raportojë pa vonesë Dhomës Gjyqësore çdo shkelje të kushteve të parashtruara më lart.

UDHËZON Sekretarin e Tribunalit që të këshillohet me Ministrinë e Drejtësisë së Holandës në lidhje me masat praktike për lirimin e Haraqisë, të caktojë zyrtarin që do të shoqërojë Haraqinë nga aeroporti Schiphol për në aeroportin e Prishtinës dhe anasjelltas dhe të vazhdojë ta mbajë Haraqinë në NJPKB në Hagë deri në kohën kur Haraqija të ketë dhënë adresën ku do të qëndrojë në Kosovë dhe deri kur Dhoma e Apelit dhe Sekretari të jenë informuar për emrin e zyrtarit të caktuar të UNMIK-ut i cili do ta shoqërojë Haraqinë nga aeroporti i Prishtinës për në vendbanimin e Haraqisë.

KËRKON prej autoriteteve të të gjitha shteteve nëpërmjet territorit të të cilëve do të udhëtojë Haraqija:

- a. ta mbajnë Haraqinë nën mbikëqyrje gjatë kohës që ai do të jetë në kalim në aeroport; dhe
- b. ta arrestojnë dhe paraburgosin Haraqinë deri në kthimin e tij në NJPKB në Hagë nëqoftëse ai orvatet të arratiset.

URDHËRON që Haraqija të arrestohet menjëherë në rast se shkel ndonjë prej kushteve dhe kufizimeve të lartpërmendura të lirimit të tij të përkohshëm.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në original/
Gjykatës Liu Daqun
Kryegjykatës

Sot, më datën 8 prill 2009.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]